

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

	Shenime	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	1,309,255	1,478,690
Llogari te arketueshme tregtare	5	70,540,702	50,519,907
Te tjera llogari te arketueshme	6	311,922	59,234
Inventari	7	23,834,123	31,965,751
Shpenzime te shtyra	8	506,117	1,657
Total Aktive Afatshkurtra		96,502,119	84,025,239
Aktivet afatgjata			
Aktive financiare	9	12,900	12,900
Aktive afatgjata materiale	10	3,455,196	3,801,840
Total aktive afatgjata		3,468,096	3,814,740
Total Aktive		99,970,215	87,839,979
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme tregtare	11	76,778,378	67,779,312
Detyrime tatimore	12	1,963,596	4,208,931
Provizione	13	364,470	364,470
Te tjera detyrime	14	308,628	324,184
Total Detyrime afatshkurtra		79,415,072	72,676,897
Detyrime afatgjata			
Total Detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		79,415,072	72,676,897
Kapitali aksionar			
Kapitali i nenshkruar		10,000	10,000
Rezerva ligjore		1,000	1,000
Rezerva te tjera		15,152,082	7,527,534
Fitimi i ushtrimit		5,392,061	7,624,548
Total kapitali aksionar	15	20,555,143	15,163,082
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		99,970,215	87,839,979

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Met-Engineering Sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	16	119,990,505	149,547,931
Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces	17	(866,978)	(26,623)
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	18	193,495	(136,793)
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(90,181,671)	(117,685,500)
Lenda e pare dhe materiale te			
1) konsumueshme	19	(88,967,726)	(116,617,015)
2) Te tjera shpenzime	20	(1,213,945)	(1,068,485)
Shpenzime te personelit	21	(21,960,540)	(21,969,213)
1) Paga dhe shperblime		(18,797,448)	(18,790,172)
2) Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore (paraqitur vecmas nga shpenzimet per pension)		(3,163,092)	(3,179,041)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(827,824)	(759,746)
Shpenzime te tjera te shfrytezimit	22	(2,878)	-
Shpenzime financiare		-	-
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)		-	-
1) ekonomike brenda grupit		-	-
2) Shpenzime te tjera financiare		-	-
Fitimi/humbja para tatimit		6,344,109	8,970,056
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23	(952,048)	(1,345,508)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin			
1) fitimin		(952,048)	(1,345,508)
Fitimi/humbja e vitit		5,392,061	7,624,548

Pasqyra e performancës duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Met-Engeneering Sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)


**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar i më 31 dhjetor 2017	10,000	1,000	3,567,358	3,960,176	7,538,534
Fitimi / Humbja e vitit				7,624,548	7,624,548
Lëvizjet përmes kapitalit			3,960,176	(3,960,176)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	10,000	1,000	7,527,534	7,624,548	15,163,082
Fitimi / Humbja e vitit				5,392,061	5,392,061
Lëvizjet përmes kapitalit			7,624,548	(7,624,548)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	10,000	1,000	15,152,082	5,392,061	20,555,143

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 u nënshkruan si më poshtë më _____ nga:

Gazmend Metohu
Administrator



MET-ENGINEERING
SH.P.K
TIRANE ALBANIA

Griselda Metaj
Ekonomiste



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shenime	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	5,392,061	7,624,548
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(180,603)	(842,692)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	603,157
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	827,824	759,746
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(93)	-
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(20,777,942)	1,016,689
Rënie/(rritje) në inventarë	8,131,628	3,657,759
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	6,753,731	(14,662,146)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(15,556)	(6,656)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	131,050	(1,849,595)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e aksioneve	-	(12,900)
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(492,002)	(1,902,568)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	10,914	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(481,088)	(1,915,468)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(350,038)	(3,765,063)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	1,478,690	4,401,061
<i>Efkti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	180,603	842,692
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	1,309,255	1,478,690
4		

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“Met-Engeneering” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Gusht 2015 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” me NIPT L52025007R.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 Lek, i zotëruar 100% nga ortakut i vetëm i Shoqërisë, Z. Gazmend Metohu. Administrator i shoqërisë është Z. Gazmend Metohu.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie ka të bëjë me veprimtarinë në fushën e ndertimit të përgjithshëm; veprimtari në fushën e projektimit dhe zbatimit; veprimtari në fushën e ujësjellës – kanalizimeve; veprimtari në fushën e prodhimit të veprave të artit, skulptura, piktura, skica, grafitë, mozaikë; veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve të ndertimit, si dhe të veprave të artit brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. “Unaza e Re”, godinë banimi dhe shërbimi, njësia II 04, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria kishte 57 punonjës (2018: 55).

2. Bazat e përgatitjes së paqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 datë 30 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.4.1 Gjykime mbi efektet pandemise ne parimin e vijimesise

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i llogarive të arketueshme, inventari dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimesisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

2.5 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr. 1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
EUR/Lek	121.77	123.42
USD/ Lek	108.64	107.82

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

	2019	2018
Aktive	Përqindja	Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%	25%
Instrumenta dhe vegla pune	20%	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.6 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit, që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare, të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15%, (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë	<u>475,582</u>	<u>1,439,778</u>
Llogari rrjedhëse	475,582	1,439,778
Mjete monetare në arkë	<u>833,673</u>	<u>38,912</u>
	<u><u>1,309,255</u></u>	<u><u>1,478,690</u></u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Klientë	70,176,232	50,155,437
Klientë për fonde garanci	364,470	364,470
	<u>70,540,702</u>	<u>50,519,907</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Detyrime doganore	8,490	6,780
Tatim mbi fitimin	251,674	-
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	51,758	52,454
	<u>311,922</u>	<u>59,234</u>

7. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Lëndë e parë dhe materiale	23,535,118	30,799,768
Produkt i gatshëm	299,005	1,165,983
	<u>23,834,123</u>	<u>31,965,751</u>

8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Parapagime	506,117	1,657
	<u>506,117</u>	<u>1,657</u>

9. Aktive Financiare

Aktivet Financiare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Aksione të shoqërisë ZMA	12,900	12,900
	<u>12,900</u>	<u>12,900</u>

10. Aktive afatgjata materiale

	Instrumenta dhe vegla pune	Automjetet	Pajisje kompjuterike	Totali
Kosto				
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	1,975,346	1,050,000	308,746	3,334,092
Shtesa	1,902,568			1,902,568
Nxjerrje jashtë përdorimit				-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2018	3,877,914	1,050,000	308,746	5,236,660
Shtesa	492,002	-	-	492,002
Nxjerrje jashtë përdorimit	(21,668)			(21,668)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2019	4,348,248	1,050,000	308,746	5,706,994
Zhvlerësimi i akumuluar				
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	(372,668)	(230,708)	(71,699)	(675,075)
Amortizimi i vitit	(536,626)	(163,858)	(59,262)	(759,746)
Nxjerrje jashtë përdorimit				
Gjëndja më 31 Dhjetor 2018	(909,294)	(394,566)	(130,961)	(1,434,821)
Amortizimi i vitit	(652,291)	(131,087)	(44,446)	(827,824)
Nxjerrje jashtë përdorimit	10,847			10,847
Gjëndja më 31 Dhjetor 2019	(1,550,738)	(525,653)	(175,407)	(2,251,798)
Vlera neto kontabël				
Gjëndja më 31 Dhjetor 2018	2,968,620	655,435	177,785	3,801,840
Gjëndja më 31 Dhjetor 2019	2,797,510	524,347	133,339	3,455,196

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Furnitorë vendas	76,066,426	67,005,141
Furnitorë të huaj	699,979	767,238
Furnitorë për fatura të pa mbëritura	11,973	6,933
	<u>76,778,378</u>	<u>67,779,312</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten të detajuara si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	410,781	431,301
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	14,052	14,300
Tatim fitimi	-	603,157
TVSH për t'u paguar	1,538,763	3,160,173
	<u>1,963,596</u>	<u>4,208,931</u>

13. Provizione

Provizionet më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Provizion për garanci punimesh	364,470	364,470
	<u>364,470</u>	<u>364,470</u>

14. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten të detajuara si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj personelit	4,832	20,388
Përfitime afatshkurtra nga sigurimet	10,896	10,896
Të tjera detyrime	292,900	292,900
	<u>308,628</u>	<u>324,184</u>

15. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 10,000 Lek, i cili zotërohet 100% nga ortaku i vetëm i shoqërisë, Z. Gazmend Metohu.

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Numri i pjesëve	1	1
Vlera e kapitalit (në Lek)	10,000	10,000
Kapitali themeltar	<u>10,000</u>	<u>10,000</u>

Fitimi i ushtrimit të Shoqërisë për vitin 2019 është në vlerën 5,392,061 Lek (2018: 7,624,548 Lek).

16. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga punime e shërbime ndërtimi për të tretë	93,436,732	118,897,616
Të ardhura nga shitja e mallrave e materialeve	7,854,236	5,959,142
Të ardhura nga shitja e produktit të gatshëm	14,064,537	18,191,173
Të ardhura nga dhënie asistence teknike	4,635,000	-
Të ardhura nga shërbime projektimi	-	6,500,000
	<u>119,990,505</u>	<u>149,547,931</u>

Më poshtë analizohet rakordimi i të ardhurave të deklaruara në Pasqyrën e Performancës dhe ato të deklaruara në FDP –në e TVSH-së dhe Tatim Fitimit:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH	120,001,435
Ndryshimi I gjendjes se parapagimeve te mara	
Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH	<u>120,001,435</u>
Punime ndertimi per te trete	93,436,732
Te ardhura nga shitja e materialeve,mallrave dhe PG	21,918,773
Të ardhura nga dhënie asistence teknike	4,635,000
Te ardhura nga shitja e AAM	10,914
Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH	<u>120,001,419</u>
Fitim nga kembimet valutore	507,598
Total te ardhura deklaruar ne FDP e Tatim Fitimit	<u>120,509,017</u>

17. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018</u>
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme	(866,978)	(26,623)
	<u>(866,978)</u>	<u>(26,623)</u>

18. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten të detajuara si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018</u>
Fitime nga këmbimet valutore	507,598	1,374,919
Humbje nga këmbimet valutore	(314,196)	(1,511,712)
Te ardhura nga shitja AAM	10,914	-
Kostua e AAM te shitura	(10,821)	-
	<u>193,495</u>	<u>(136,793)</u>

19. Materiale të para dhe të konsumueshme

Kostoja e materialeve të para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018</u>
Kosto e materialeve të para	76,864,372	81,947,333
Kosto e mallrave	5,258,755	3,730,234
Nenkontraktor	603,304	23,874,870
Mirëmbajtje riparime	296,679	696,400
Shpenzime transporti për shitje/blerje	413,795	869,540
Shpenzime certifikimi	520,429	419,672
Qera	4,934,000	5,034,000
Prime sigurimi	20,790	22,000
Energji elektrike	55,602	22,966
	<u>88,967,726</u>	<u>116,617,015</u>

20. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
Qera zyre	160,452	128,597
Konsulenc Ekonomike -Juridike	150,000	120,000
Taksa te ndryshme	386,442	369,000
Shpenzime telefon, internet	113,899	109,642
Sherbime bankare	86,534	74,760
Shpenzime doganore	47,969	26,700
Shpenzime administrative	267,449	221,370
Shpenzime te ndryshme	1,200	18,416
	1,213,945	1,068,485

21. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
Shpenzime për paga	18,797,448	18,790,172
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,163,092	3,179,041
	21,960,540	21,969,213

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 57. (2018: 55).

22. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
Gjoha dhe penalitete	2,878	-
	2,878	-

23. Tatimi mbi fitimin

Formularët e deklaramit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	6,344,109	8,970,056
Te ardhura jo tatimore (falja e gjobave)		
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	2,878	-
Penalitet, gjoba e demshperblime	2,878	-
<i>Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)</i>	<u>6,346,987</u>	<u>8,970,056</u>
 <i>Tatim fitimi @15%</i>	 952,048	 1,345,508
 Tatim fitimi	 <u><u>5,392,061</u></u>	 <u><u>7,624,548</u></u>

24. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

25. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i llogarive të arketueshme, inventari të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 2.4.1 të këtyre pasqyrave financiare.

www.mazars.al